(I MIRATUAR ME ANË TË NJË VENDIMI TË VEÇANTË TË SHOQËRISË,
DT. 20 KORRIK 2007)**

I

TABELA A

Stream Oil & Gas Ltd. ("Shoqeria") nuk do t'u nënshtrohet rregulloreve që përmban apo parashikon Tabela "A" në pjesën e parë të Ligjit dhe Nenet e mëposhtme do të përbëjnë Nenet e statutit të Shoqërisë.

INTERPRETIMI

1. Për efekt të këtij Statuti, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar përbri tyre, përveç rastit kur ky kuptim bie në kundërshtim me objektin e Statutit apo kontekstin:

"Nenet" nënkupton këto Nene të statutit të shoqërsë, të ndryshuara apo të zëvendësuara herë pas here.

"Klasa" apo **"Klasat"** nënkupton çdo kategori apo kategoritë e kuotave, që mund të nxirren kohë pas kohe nga Shoqëria.

"Drejtorët" nënkupton drejtorët e shoqërisë në momentin në fjalë, apo nëse është rasti, drejtorët e mbledhur si një bord apo si një komitet.

"Llogari investimi" do të ketë kuptimin që do t'i atribuohet këtui.

"Ligj" nënkupton Ligjin për Shoqëritë të Cayman Islands (I ndryshuar).

"Akti i Themelimit të Shoqërisë" nënkupton Aktin e Themelimit të shoqërisë me ndryshimet apo zëvendësimet që ka pësuar kohë pas kohe

"Zyra" nënkupton Zyrën e regjistruar të Shoqërisë, në mënyrën e parashikuar nga Ligji.

"Vendimet e zakonshme" nënkupton vendime që:

- (a) Miratohen me shumicë të thjeshtë të Ortakëve, me të drejtë vote në mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme, të cilët votojnë personalisht, apo në rastet kur

përfaqësimi lejohet, me prokurë, në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

- (b) Miratohen me shkrim nga të gjithë ortakët me të drejtë vote në Mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme, të cilët kanë të drejtë vote në një mbledhje të përgjithshme të shoqërisë, duke u pasqyruar në një apo më shumë dokumente ligjore, secili prej tyre i nënshkruar nga një apo më shumë ortakë dhe data e hyrjes në fuqi të të cilave konsiderohet data në të cilën ekzekutohet mjeti ligjori, apo i fundit prej tyre kur janë disa të tillë.

“Shlyerja” nënkupton shlyerjen e kuotave në përputhje me ylerën e tyre nominale të emetimit dhe përfshin edhe ato kuota që kreditohen si të shlyera.

“Person” nënkupton çdo person fizik, firmë, shoqëri, joint venture, ortakëri, korporatë, bashkim, apo entitet tjetër (me ose jo personalitet të veçantë ligjor) apo ndonjë prej tyre në varësi të kontekstit.

“Regjistër” nënkupton regjistrin ku pasqyrohen Anëtarët e Shoqërisë, në përputhje me dispozitat ligjore.

“Vula” nënkupton vulën e zakonshme të shoqërisë (nëse ndryshohet), si dhe një kopje të saj.

“Sekretar” nënkupton çdo person të caktuar nga Drejtorët për të kryer cilëndo nga detyrat e sekretarit të shoqërisë.

“Kuotë” nënkupton një Kuotë në kapitalin e Shoqërisë. Në çdo rast që këtu përmendet “kuota”, do të konsiderohen se janë Kuota të një apo të gjitha Klasave, sipas kontekstit. Për të shmangur dyshimet në këto Nene, termi “Kuotë” do të përfshijë pjesën e një Kuote.

“Ortak” apo **“Anëtar”** nënkupton një person, i cili është i regjistruar në Regjistër si mbajtës i Kuotave, duke përfshirë çdo nënshkrues të Aktit të Themelimit të Shoqërisë në pritje të emetimit të Kuotës apo Kuotave.

“Llogaria e Primit të Kuotës” nënkupton llogarinë nga e cila kreditohet shuma e paguar (ose e premtuar për t’u paguar) nga Ortaku për Kuotën, e vendosur në përputhje me Nenet e Statutit dhe me Ligjin.

“nënshkruar” nënkupton mbajtjen e një nënshkrimi apo përfaqësimin e një nënshkrimi të kryer me mjete mekanike dhe

“Vendim i veçantë” nënkupton një vendim të veçantë të shoqërisë, të miratuar në përputhje me ligjin, i cili:

- (a) Miratohet nga shumica e jo më pak se dy të tretave e Ortakëve me të drejtë vote, të cilët votojnë personalisht apo në rastin kur lejohet votimi me prokurë, me anë të prokurës në Asamblenë e Përgjithshme, lajmërimi i së cilës është bërë në mënyrë të rregullt, duke cilësuar qëllimin për të propozuar një vendim

si vendim të veçantë dhe miratohet duke llogaritur shumicën e numrit të votave që zotëron secili Ortak, ose

(b) Miratohet me shkrim nga të gjithë Ortakët me të drejtë vote, nga Asambleja e Përgjithshme, duke u pasqyruar në një apo më shumë dokumenta ligjore, secili prej tyre i nënshkruar nga një apo disa ortakë. Data e hyrjes në fuqi të vendimit të miratuar si mësipër do të jetë data në të cilën ekzekutohet dokumenti ligjor apo i fundit prej dokumentave ligjore, në rastin kur ka disa të tilla.

2. Në këto Nene, përveç rasteve kur konteksti kërkon ndryshe:

- a. Fjalët që shprehin numra në njëjës do të përfshijnë dhe numrin në shumës dhe e anasjellta.
- b. Fjalët që shprehin vetëm gjininë mashkullore do të përfshijnë gjininë femërore apo ndonjë person sipas kontekstit.
- c. Fjala "**mund**" do të interpretohet si lejuese dhe fjala "**do të**" do të interpretohet si urdhëruese.
- d. Përdorimi i një **dollar** apo **dollarë** apo (\$) dhe i **cent** apo **centë** u referohen dollarëve dhe centëve të Shteteve të Bashkuara.
- e. Përmendja e një **dokumenti statutor** i referohet ndonjë ndryshimi apo rimiratimi gjatë kohës që është në fuqi.
- f. çdo veprim i Drejtorëve do të shprehet si veprim i kryer nga Drejtorët në diskrecionin e tyre të plotë dhe do të jetë i zbatueshëm, si në raste të përgjithshme, ashtu edhe në raste të veçanta, dhe
- g. shprehja "**me shkrim**" do të nënkuptojë çdo gjë të shkruar, apo të prezantuar me anë të ndonjë mjeti të riprodhueshëm me shkrim, përfshirë këtu çdodolloj printimi, litografi, e-mail, faksimile, fotografi apo telex apo të përfaqësuara nga ndonjë tjetër formë zëvendësuese apo format për ruajtjen apo transmetim me shkrim, apo pjesërisht njërën dhe pjesërisht tjetrën.

3. Çdo fjalë e përmendur në dy nenet e fundit të mësipërme, dhe e parashikuar në Ligj, do të ketë të njëjtin kuptim si në dispozitën ligjore, përveç rastit kur ky kuptim vjen në kundërshtim me kontekstin ku ndodhet fjala apo me përmbajtjen e Statutit.

PARAPRAKE

4. Veprimtaria e shoqërise mund të fillojë në çdo moment pas themelimit të saj

5. Zyra do të jetë në adresën në Cayman Islands që Drejtorët mund të përcaktojnë kohë pas kohe. Shoqëria mund të vendosë gjithashtu të ketë zyra të tjera, vende të ndryshme për të kryer aktivitetin e saj, si dhe agjensi në vendet që mund të përcaktohen kohë pas kohe nga ana e Drejtorëve.
6. Shpenzimet paraprake të bëra për formimin e shoqërisë dhe në lidhje me emetimin e kuotave do të paguhet nga Shoqëria. Këto shpenzime do të amortizohen në një periudhë të tillë e cila do të përcaktohet nga ana e Drejtorëve dhe shuma e tillë e paguar do të zbritet nga të ardhurat dhe/ose kapitali në llogaritë e kompanisë sipas vendimit të Drejtorëve.
7. Drejtorët do të mbajnë, apo do të vendosin që Rregjistri të mbahet në vendin që ata do të përcaktojnë herë pas here dhe në mungesë të një përcaktimi të tillë, Rregjistri do të mbahet në Zyrë.

KUOTAT

8. Në bazë të këtyre Neneve, të gjitha Kuotat të cilat nuk janë emetuar për momentin do të jenë nën kontrollin e Drejtorëve të cilët mund të:

- a) Emetojnë, shpërndajnë dhe u japin të njëjtat kuota Personave të caktuar, në mënyrën, kushtet apo kufizimet që ata përcaktojnë kohë pas kohe; dhe
- b) Japin opsione në lidhje me Kuota të tilla dhe emetojnë garanci apo mjete të ngjashme në lidhje me to

Dhe, për këto qëllime Drejtorët mund të rezervojnë një numër të përshtatshëm Kuotash, të cilët nuk janë të emetuar për momentin.

9. Drejtorët mund të autorizojnë ndarjen e Kuotave në cilindo numër Klasash dhe Klasat e ndryshme duhet të autorizohen, vendosen dhe cilësohen (apo ricilësohen, sipas rastit) dhe variacionet në të drejtat relative (duke përfshirë pa kufizim votimin, dividendin dhe të drejtat e riblerjes) kufizimet, preferencat, privilegjet dhe pagesat e detyrueshme, ndërmjet klasave të ndryshme (nëse ka ndonjë), elementë të cilët do të përcaktohen dhe vendosen nga Drejtorët.
10. Shoqëria për aq sa mund të lejohet me ligj, mund t'i paguajë komision ndonjë Personi në bazë të nënshkrimit të tij apo marrëveshjes për të nënshkruar ndonjë kuotë, qoftë ky nënshkrim i plotë, apo me kusht. Komisione të tilla mund të kryhen nëpërmjet pagimit me para në dorë, apo nëpërmjet depozitimit të Kuotave të shlyera apo pjesërisht të shlyera, apo të kryhet pjesërisht në njërin mënyrë dhe pjesërisht në tjetrën. Shoqëria mundet që gjithashtu për emetimin e Kuotave të paguajë një ndërmjetësim për aq sa mund të jetë e drejtë.
11. Drejtorët mund të refuzojnë që të pranojnë ndonjë kërkesë për Kuota dhe mund të pranojnë ndonjë kërkesë në tërësi apo pjesërisht për ndonjë arsye ose pa arsye.

NDRYSHIMI I TË DREJTAVE

12. Kurdo që kapitali i shoqërisë është i ndarë në Klasa të ndryshme, të drejtat që i korrespondojnë secilës prej tyre mundet (për aq sa nuk parashtrohet e kundërta nga kushtet e emetimit të Kuotave të asaj Klase) që të ndryshohen materialisht në mënyrë të kundërt apo të abrogohen vetëm me pëlqimin me shkrim të mbajtësve të jo më pak se dy të tretat e Kuotave të emetuara të asaj Klase, ose me përcaktimin e një vendimi të miratuar në një mbledhje të vecantë të mbajtësve të Kuotave të asaj Klase, nga shumica e dy të tretave të votave në atë takim, por jo në raste të tjera. Për secilin nga takimet e përmendura mësipër, të gjitha dispozitat e Neneve që kanë të bëjnë me Mbledhjet e Përgjithshme, apo me procedurat e ndjekura në to, zbatohen, *mutatis mutandis*, me përjashtim të faktit që kuorumi i nevojshëm do të jetë të paktën një apo më tepër Persona të cilët mbajnë apo përfaqësojnë me autorizim një të tretën e vlerës nominale të Kuotave të emetuara të klasës përkatëse (por në një mënyrë të tillë që nëse cilindo prej takimeve të tilla të shtyra të Ortakëve, kuorumi i përcaktuar më lart nuk është formohet, Ortakët të e pranishëm duhet të formojnë një kuorum) dhe në varësi të kushteve të emetimit të Kuotave të asaj Klase, çdo ortak i asaj klase do të ketë në votim të drejtën e një vote për çdo Kuotë të asaj Klase. Me qëllim të realizimit të mbledhjes së një takimi sipas këtij Neni, Drejtorët mund të vendosin t'i trajtojnë të gjitha Klasat apo grupe me dy apo më shumë Klasa si të formonin një Klasë të vetme, në rastet kur ata vlerësojnë se të gjitha këto Klasa do të prekeshin në të njëjtën mënyrë nga propozimet e bëra, por në çdo rast tjetër ato do të trajtohen si Klasa të veçanta.
13. Të drejtat e njohura zotëruesve të Kuotave të cilësdo Klasë, të emetuara me preferencë apo të drejta të tjera, përveç rastit kur parashikohet ndryshe shprehimisht në kushtet e emetimit të Kuotave të asaj Klase, nuk do të mund të ndryshohen materialisht, apo të abrogohen nga, *inter alia*, krijimi, ndarja apo emetimi i Kuotave të mëtejshme duke rradhitur *pari passu*, me apo për rrjedhojë të tyre, riblerjen apo blerjen e koutave të cilësdo Klasë të Kompanisë.

ÇERTIFIKATAT

14. Asnjë Person nuk do të ketë të drejtë për të pasur një Çertifikatë titulli për një apo të gjitha kuotat e tij, përveçse kur Drejtorët vendosin ndryshe.

KUOTAT E PJESSHME

15. Drejtorët mund të emetojnë pjesë të një Kuote dhe në këtë rast, kjo pjesë e koutës do të jetë subjekt i dhe do të mbajë pjesën korrespondues të përgjegjësiave (pavarësisht nëse kanë të bëjnë me vlerën nominale, premiumin, kontributet, propozimet apo të tjera) për kufizimet, preferencat, privilegjet, kualifikimet, frenimet, të drejtat (duke përfshirë këtu pa paragjykim të mësipërmet, votimi dhe të drejtat e pjesëmarrjes) dhe për attribute të tjera të një Kuote të tërë. Në rastin kur më shumë se një fraksion i një Kuote të së njëjtës Klasë është emetuar për apo është blerë nga i njëjti Ortak, këto pjesë do të bashkohen.

PENGJET

16. Shoqëria do të ketë një peng me prioritet në ngarkim të secilës Kuotë të shlyer pjesërisht (pavarësisht nëse aktualisht janë apo jo të pagueshme) e detyruar për t'u paguar, ose që mund të paguhet në një kohë të caktuar në lidhje me atë Kuotë. Shoqëria gjithashtu do të ketë një peng prioritar në ngarkim të të gjitha Kuotave të shlyera pjesërisht, të regjistruara në emrin e një Ortaku (pavarësisht nëse zotërohen vetëm apo së bashku me një Person) për të gjitha paratë aktualisht të paguara nga ai apo nga pasuria e tij ndaj shoqërisë. Drejtorët kanë të drejtë që në çdo kohë, të përjashtojnë ndonjë Kuotë plotësisht apo pjesërisht nga dispozitat e këtij Neni. Pengjet e shoqërisë, nëse ka, në lidhje me një Kuotë, shtrihen mbi të gjithë dividendët që llogariten mbi të.
17. Shoqëria mund të shesë në mënyrën që Drejtorët në vlerësimin e tyre tërësisht të lirë e konsiderojnë si të përshtatshme, secilën nga Kuotat mbi të cilat Shoqëria ka një peng, por kjo shitje nuk mund të realizohet nëqoftëse nuk paraqitet Brenda katërmëdhjetë ditëve pas njoftimit me shkrim, i cili shpall dhe kërkon shlyerjen e kësaj pjese të shumës në bazë të së cilës ekziston pengu. Kjo shumë duhet t'i jetë dorëzuar zotëruesit të regjistruar gjatë ekzistencës së Kuotës, apo Personave të legjitimuar si titullarë për shkak të vdekjes apo falimentimit të tij.
18. Për kryer një shitje në kushtet e sipërpërmendura Drejtorët mund të autorizojnë disa Persona që këta të fundit t'ua transferojnë Kuotat e shitura blerësit të tyre. Blerësi do të regjistrohet si zotërues i Kuotave të përfshira në ndonjë transfertë të tillë dhe ai nuk do të jetë i detyruar të ndjekë procedurën e pagimit të çmimit të blerjes dhe nga ana tjetër titulli i tij mbi Kuotat nuk do të ndikohet nga ndonjë parregullsi apo pavlefshmëri në procedurat që lidhen me shitjen.
19. Procedurat e shitjes pas zbritjes së shpenzimeve, tarifave apo komisioneve të mbajtura nga Shoqëria, do të pranohen nga Shoqëria dhe do të zbatohen duke paguar pjesën e shumës për të cilën ekziston pengu i shlyeshëm në atë moment dhe mbetja (subjekt i një pengu të ngjashëm për shumën jo të shlyeshme në atë moment, në mënyrën siç ka ekzistuar mbi Kuotat përpara shitjes) do t'i paguhet Personit që është titullar i Kuotave në datën e shitjes.

INTERESAT E VENDOSURA MBI KUOTAT

20. Drejtorët kanë të drejtë që herë pas here të vendosin që Ortakët që nuk kanë paguar ndonjë detyrim në shume parash, të paguajnë interesa të llogaritura mbi pjesët e shlyera të Kuotave të tyre dhe secili Ortak duhet që (pasi të ketë marrë njoftim të paktën katërmëdhjetë ditë përpara, ku të përcaktohet hera apo herët në të cilat duhet të kryehet shlyerja e detyrimit në fjalë) t'i paguajë Shoqërisë në herën apo herët e përcaktuara shumën e vendosur si interes mbi Kuotat respektive.

21. Zotëruesit e përbashkët të një Kuote përgjigjen së bashku dhe respektivisht për penalitetet monetare të vendosura mbi to.
22. Nëse një shumë e vendosur si penalitet mbi një Kuotë nuk paguhet përpara apo në ditën e caktuar për pagesën e saj, Personi të cilit i ngarkohet përgjegjësia duhet të paguajë edhe interes mbi shumën që detyrohet në masën tetë përqind në vit, që nga dita kur duhet të kryhej pagesa e deri në ditën kur pagesa kryhet realisht. Drejtorët kanë të drejtë të heqin dorë nga kërkitimi i pagimit të këtij interesi tërësisht apo pjesërisht.
23. Dispozitat e këtyre Neneve që lidhen me përgjegjësitë e disa Ortakëve së bashku dhe me pagimin e interesit, do të zbatohen edhe në rastin e mospagimit të ndonjë shume, e cila sipas kushteve të emetimit të Kuotës përcaktohet si e shlyeshme në një moment të caktuar, qoftë kjo për llogari të vlerës së Kuotës, apo nëpërmjet primit të emetimit, në të njëjtën mënyrë si të ishte bërë e shlyeshme si rezultat i një penaliteti monetary, të kryer dhe të njoftuar sipas rregullave.
24. Drejtorët mund të realizojnë marrëveshje për diferencimin e Ortakëve apo të Kuotave të veçanta në lidhje me çështjen e kuotave të shlyera pjesërisht, përsa i përket interesit që ata duhet të paguajnë mbi to apo kohës në të cilën duhet të shlyejnë vlerën e mbetur të Kuotave.
25. Drejtorët kanë të drejtë, që nëse e mendojnë të përshtatëshme, të marrin nga çdo Ortak që do të shlyejë përpara kohe të tërë apo një pjesë të parave që nuk u janë kërkuar atyre (Ortakëve) ende për t'u paguar, apo që nuk janë shlyer ende prej tyre në lidhje me ndonjë pjesë kuotash të shlyera pjesërisht, të zotëruara nga Ortaku në fjalë dhe në këto kushte (përderisa e mbetet e njëjta shumë, por për shkak të një pagimi të tillë paraprak bëhet e pagueshme në atë moment) të vendosin që Ortaku të paguajë një përqindje interesi (pa tejkaluar pa miratimin e një vendimi të Asamblesë së Zakonshme tetë përqind në vit) të përcaktuar në marrëveshje mes tyre (Drejtorëve) dhe Ortakëve që do paguajnë paraprakisht.

KONFISKIMI I KUOTAVE

26. Nëse një ortak nuk paguan interesin e shlyera apo kështu e interesit në lidhje me kuotat e shlyera pjesërisht, në ditën e caktuar, Drejtorët kanë të drejtë që në çdo moment pas kësaj date përsa kohë që ndonjë pjesë e këtij interesi apo kësti të këtij interesi mbetet e pashlyer, t'i bëjnë thirrje Ortakut përgjegjës nëpërmjet një njoftimi, që të shlyejë interesin apo kështu e papaguar të interesit, duke paguar për vonesën edhe interesat e shtuara mbi vlerën e sipërpërmendur.
27. Njoftimi duhet të përcaktojë një ditë të mëpasme (jo më herët se katërmbëdhjetë ditë nga data e njoftimit) në të cilën ose përpara së cilës duhet të shlyhet pagesa e kërkuar në njoftim dhe në të duhet të përcaktohet se në rast mospagimi në ose përpara datës së caktuar në njoftim, kuotat në lidhje me të cilat ishte bërë njoftimi, do të konfiskohen.

28. Nëse kërkesat e një njoftimi të bërë në kushtet e mësipërme nuk plotësohen në kohën e përcaktuar në të, çdo Kuotë në lidhje me të cilën është dhënë ky njoftim, mund të konfiskohet nëpërmje vendimit të Drejtorëve në çdo moment pas kalimit të datës së përcaktuar për t'u kryer pagesa.
29. Një Kuotë e konfiskuar mund të shitet ose të disponohet në kushtet dhe në mënyrën që Drejtorët do e konsiderojnë si më të përshtatshme. Konfiskimi mund të hiqet në çdo moment përpara shitjes apo disponimit të kuotës nëse Drejtorët e shohin të përshtatshme.
30. Personi Kuotat e të cilit janë konfiskuar nuk do të jetë më pronar i Kuotave të konfiskuara, por pavarësisht nga kjo, mbetet përgjegjës ndaj shoqërisë për të shlyer të gjitha paratë që duhet t'i paguante asaj në datën e konfiskimit. Përgjegjësia e tij mbaron në momentin që ai i shlyen Shoqërisë të gjithë shumën e papaguar të Kuotave të konfiskuara.
31. Një deklaratë statutore me shkrim, ku të përcaktohet se deklaruesi është Drejtor dhe se një Kuotë është konfiskuar sipas rregullave në datën e caktuar në deklaratë, do të përbëjë provë të plotë në lidhje me faktet në deklaratë, përkundërt të gjithë personave që pretendojnë se kanë titull mbi Kuotën.
32. Shoqëria mund të marrë në parasysh, nëse ka, propozimet e bëra në lidhje me shitjen apo përdorimin e ndonjë Kuote në lidhje me parashikimet e Neneve të mësipërme mbi konfiskimin dhe mund të kryejë transfertën e Kuotës në favor të Personit të cilit ajo i është shitur apo në favor të të cilit është disponuar, Personi i cili do të rregjistrohet si zotërues i Kuotës dhe i cili nuk ka detyrimin të merret me kërkesën e shumës së blerjes, nëse ka dhe, titulli i tij mbi Kuotën nuk mund të ndikohet nga asnjë parregullsi apo pavlefshmëri në procedurat e disponimit apo të shitjes.
33. Dispozitat e Neneve të mësipërme që lidhen me konfiskimin do të zbatohen edhe në rastin e mospagimit të ndonjë shume, e cila sipas kushteve të emetimit të Kuotave, bëhet e detyrueshme dhe e pagueshme, qoftë përse i preket shumës së Kuotës, apo nëpërmjet primit, në të njëjtat kushte si të ishte e pagueshme si rezultat i një interesi të vendosur dhe njoftuar sipas rregullave.

TRANSFERIMI I KUOTAVE

34. Në rastin kur një Kuotë është objekt i ndonjë të drejte apo kufizimi, si rezultat i përkatësisë në një Klasë, ajo nuk mund të tjetërsohet, transferohet, apo disponohet, pa marrë më parë miratimin me shkrim të Drejtorëve apo agjentëve të tyre të autorizuar, të cilët kanë diskrecion të plotë në dhënien e këtij miratimi.
35. Dokumenti formal ku do të pasqyrohet tjetërsimi i ndonjë Kuote mund të jetë në çdo formë të zakonshme, apo në një formë tjetër të përcaktuar nga Drejtorët sipas diskrecionit të tyre. Ky transferim duhet të ekzekutohet nga ose për llogari të transferuesit në rastin e një Kuote me vlerë zero, apo të shlyer pjesërisht, ose, nëse kërkohet nga Drejtorët, duhet të ekzekutohet gjithashtu për llogari të atij që i

kalon pronësia mbi Kuotën dhe duhet të shoqërohet nga çertifikata (nëse ka) e Kuotave respektive, si dhe duhet të paraqitet çdo lloj evidence tjetër që Drejtorët në mënyrë të arsyeshme mund të kërkojnë për të vërtetuar të drejtën e transferuesit për të kryer kalimin e titullit. Transferuesi do të konsiderohet si Ortak (pronar i Kuotave në fjalë) derisa emri i pritësit të transfertës të shënohet në Rregjistrin e pronar i Kuotave, objekt transferimi.

36. Drejtorët kanë të drejtë që duke ushtruar diskrecionin e tyre të mos regjistrojnë një tjetërsim Kuotash, pa qenë të detyruar të japin asnjë arsye.
37. Regjistrimi i tjetërsimit të Kuotave mund të ndërpritet në momentin dhe për atë kohë sa vendosin Drejtorët.
38. Të gjitha dokument ku pasqyrohet kalimi i pronësisë së Kuotave dhe që janë të regjistruara do të mbahen nga Shoqëria, ndërkohë që çdo document, të cilin Drejtorët kanë refuzuar ta regjistrojnë (me përjashtim të një rasti mashtrimi) i kthehet Personit që e ka depozituar.

TRANSMETIMI I KUOTAVE

39. Përfaqësuesi ligjor personal i një Ortaku të vetëm të një Kuote, i cili ka vdekur, do të jetë i vetmi person, që Shoqëria do ta njohë si titullar të Kuotës. Në rastin e një Kuote të regjistruar në emër të dy apo më shumë Ortakëve, Ortaku/ët e mbetur gjallë, apo përfaqësuesit e tyre ligjorë, do të jenë të vetmit Persona të njohur nga Shoqëria si titullarë të Kuotës.
40. Çdo person që bëhet titullar i Kuotës si rezultat i vdekjes apo falimentimit të një Ortaku, pas paraqitjes së provave që mund të kërkojnë herë pas here nga Drejtorët, do të ketë të drejtën për t'u regjistruar si Ortak (pronar i Kuotës) apo në vend që të regjistrohet vetë, ai mund të kryejë një transfertë të Kuotës si ishte vetë personi që ka vdekur apo personi që ka falimentuar. Por, në çdo rast Drejtorët kanë të njëjtën të drejtë për të refuzuar apo ndërprerë regjistrimin, siç mund të refozonin regjistrimin në rastin e transferimit të Kuotës nga ana e Personit të vdekur apo të falimentuar përpara vdekjes apo falimentimit.
41. Personi që fiton titullin e pronësisë mbi një Kuotë si rezultat i vdekjes apo falimentimit të një Ortaku, ka të drejtë të përfitojë të njëjtat dividende dhe avantazhe të tjera, që do të kishte po të ishte Ortak i regjistruar, vetëm se ai nuk mund të ushtrojë asnjë të drejtë si anëtar në lidhje me Mbledhjet e Shoqërisë përpara se të regjistrohet si Ortak (pronar i Kuotës respektive).

NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

42. Shoqëria, herë pas here, mund të vendosë me anë të një Vendimi të Zakonshëm të zmadhojë vlerën e kapitalit themeltar me një masë të caktuar, e cila do të ndahet në numrin, shumën dhe Klasën e Kuotave të përcaktuara në vendim.
43. Shoqëria mundet që me anë të një Vendimi të Zakonshëm:

- (a) të bashkojë dhe ndajë të gjitha apo një pjesë të Kapitali të saj Themeltar në Kuota me vlerë më të madhe se ajo ekzistuese.
- (b) t'i vendosë të gjitha apo një pjesë të Kuotave të saj të shlyera si rezervë dhe t'i rikthejë këto rezerva në Kuota të shlyera të çfarëdolloj kategorie.
- (c) të nënndajë Kuotat e saj ekzistuese, apo ndonjërin prej tyre në Kuota të një shume më të vogël, me kusht që pas ndarjes, raporti ndërmjet shumës së paguar dhe shumës së papaguar (në ka) ndaj çdo Kuote të zvogëluar, të jetë i njëjtë si ishte në rastin e Kuotës nga e cila ka rrjedhur Kuota e reduktuar.; dhe
- (d) të anulojë çdo Kuotë, e cila në datën e miratimit të vendimit, nuk është marrë apo nuk është rënë dakord të merret nga ndonjë Person dhe të zvogëlojë shumën e kapitalit themeltar në vlerën e Kuotave të anuluar.
44. Shoqëria ka të drejtë të zvogëlojë kapitlajn e saj themeltar apo të zvogëlojë kapitalin rezervë me anë të një Vendimi të Veçantë, konform parashikimeve të dispozitave ligjore.

RIBLERJA DHE BLERJA E KUOTAVE

45. Në bazë të ligjit, Shoqëria ka të drejtë të:
- (a) të emetojë Kuota në mënyrë që ato mund të riblihen, apo të jenë të mundura të riblihen nga Shoqëria apo Ortaku, në kushtet dhe mënyrën që përcaktojnë Drejtorët herë pas here.
 - (b) të blejë Kuotat e veta (përfshirë këtu Kuotat e mundura për t'u riblerë) në kushtet dhe mënyrën që Drejtorët vendosin apo bien dakord me Ortakë dhe,
 - © të kryejë pagesën për riblerjen apo blerjen e Kuotave të saj, në mënyrat e lejuara nga ligji, duke përfshirë kapitalin e saj, përfitimin apo primin e emetimit të ri të Kuotave.
46. Cdo Kuotë për të cilën është shpallur njoftim për riblerje, nuk mund të marrë pjesë në përfitimet e Shoqërisë që nga data e caktuar si data e riblerjes në njoftimin e riblerjes.
47. Riblerja apo blerja e një Kuote nuk mund të ndikojë në rritjen e cmimit të riblerjes apo blerjes së një Kuote tjetër.
48. Drejtorët kanë të drejtë që kur kryejnë pagesa për shpërblimin apo blerjen e Kuotave, të paguajnë shumat respektive me para në dorë apo t'i depozitojnë ato në llogaritë përkatëse, në rastet kur autorizohen për këtë nga kushtet emetimit të Kuotave, apo nga marrëveshja e arritur me zotëruesin e Kuotave.

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

49. Drejtorët kanë të drejtë që të thërrasin një Asamble të Përgjithshme të Shoqërisë sa herë që ata e konsiderojnë të nevojshme.
50. Asamblëtë e Përgjithshme thirren gjithashtu me kërkesën me shkrim të një apo disa Ortakëve, që kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në Asamblëtë e Përgjithshme të Shoqërisë, të cilët zotërojnë të paktën shumicën e kapitalit themeltar të shlyer. Kjo kërkesë depozitohet në Zyrën e Shoqërisë. Kërkesa e mësipërme duhet të përcaktojë rendin e ditës dhe datën në të cilën duhet të mbledhet Asambleja e Përgjithshme, datë e cila nuk mund të jetë më vonë se 21 ditë nga data në të cilën është depozituar kërkesa e nënshkruar nga kërkuuesit. Nëse Drejtorët nuk thërrasin Asamblenë e Përgjithshme brenda 45 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës, Ortakëve (kërkuessve) u lind e drejta të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në të njëjtën mënyrë (për aq sa është e mundur) si të thirrej nga Drejtorët dhe të gjitha shpenzimet e arsyeshme që do të paguheshin nga kërkuuesit si rezultat i mosthirrjes së Asamblesë së Përgjithshme nga Drejtorët, do t'i shlyhen Shoqërisë nga këta të fundit.
51. Në rastin kur për momentin nuk ka Drejtorë, çdo dy Ortakë (nëse është vetëm një Ortak, atëherë Ortaku i vetëm) me të drejtë votë në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë, mund të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në të njëjtën mënyrë (për aq sa është e mundur) që kjo e fundit do të thirrej nga Drejtorët.

NJOFTIMI I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

52. Njoftimi duhet të bëhet të paktën 7 ditë përpara datës kur do të mbledhet Asambleja; sic parashikohet në këto Nene dhe në të duhet të përcaktohet vendi, dita dhe ora e mbledhjes së Asamblesë dhe, në rast të çështjeve të vecanta për diskutim, duhet përshkruar edhe natyra e çështjes në fjalë. Njoftimi duhet të kryhet në mënyrën e përcaktuar më poshtë, osë në një mënyrë tjetër që mund të vendoset nga Shoqëria me anë të një Vendimi të Zakonshëm të saj (nëse ka). Njoftimi u drejtohet Personave, të cilët në bazë të Neneve të këtij Statuti njihen nga Shoqëria si titullarë dhe kanë të drejtë të njoftohen nga Shoqëria për zhvillimin e mbledhjeve të sipërpërmendura. Por, në rastin kur të gjithë Ortakët që kanë të drejtë të njoftohen për zhvillimin e Asambleve të Vecanta dhe kanë të drejtën e votës në to, e lejojnë, Asambleja mund të thirret me një njoftim të thjeshtë, ose pa njoftim, në mënyrën që Ortakët e mësipërm e mendojnë si më të përshtatshme.
53. Mosnjoftimi pa qëllim i një Mbledhjeje të Asamblesë apo mosmarrja e njoftimit për zhvillimin e një mbledhjeje nga ndonjëri prej Ortakëve nuk e bën të pavlefshme procedurat e ndjekura në mbledhjen së Asamblesë.

PROCEDURAT E NDJEKURA NË MBLEDHJET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

54. Të gjitha çështjet mbi të cilat vendoset në mbledhjen e Asamblesë konsiderohen të Vecanta, me kusht që në to të vendoset mbi ndarjen e dividendëve, vlerësimin e

llogarive, bilancit, raportet e Drejtorëve mbi auditimin e Shoqërisë, emërimin dhe shkarkimin e Drejtorëve dhe caktimi i shpërblimit të personave që bëjnë auditimin e Shoqërisë. Në një mbledhje të Asamblesë së Zakonshme nuk mund të diskutohet asnjë çështje e vecantë pa miratimin paraprak të Ortakëve që kanë të drejtë të marrin pjesë në këtë mbledhje, përveç rastit kur çështja e vecantë në fjalë është përshkruar në rendin e ditës, që përmbante njoftimi i bërë për zhvillimin e mbledhjes.

55. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të vendoset mbi asnjë çështje nëse në të nuk merr pjesë kuorumi i caktuar i Ortakëve. Përveç rasteve të parashikuara në Nenet e këtij Statuti, kuorumi i nevojshëm formohet edhe nga një Ortak i vetëm apo disa Ortakë, që marrin pjesë në mbledhje personalisht, apo përfaqësohen nga një person tjetër me prokurë, të cilët zotërojnë në kapitalin themeltar të paktën shumicën e kuotave të shlyera.
56. Nëse brenda gjysmë ore nga ora e përcaktuar për t'u zhvilluar mbledhja nuk paraqitet kuorumi i nevojshëm, mbledhja e thirrur me kërkesë të Ortakëve, shpërndahet. Në cdo rast tjetër, ajo do të mbledhet të njëjtën ditë të javës pasardhëse, në të njëjtën orë dhe vend dhe nëse brenda gjysmë ore nga ora e përcaktuar për t'u zhvilluar mbledhja kuorumi i nevojshëm nuk është paraqitur ende, Ortaku apo Ortakët me të drejtë vote që janë prezentë konsiderohet se formojnë kuorumin e nevojshëm.
57. Nëse Drejtorët vendosin t'u krijojnë Ortakëve lehtësinë për njoftimin mbi një apo të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, ata mund t'i njoftojnë Ortakët për thirrjen e mbledhjes/ve nëpërmjet telefonit apomjeteve të tjera të komunikimit që lejojnë që të gjithë Personat që do të marrin pjesë në këtë (këto) mbledhje të komunikojnë lirisht me njëri-tjetrin dhe ky lloj kuminkimi të mundësojë pjesëmarrjen e tyre personalisht në mbledhje.
58. Nëse ka, Kryetari i Drejtorëve do të drejtojë të gjitha mbledhjet si Kryetar i tyre.
59. Nëse nuk ka Kryetar të Drejtorëve, ose në rastin kur ai nuk paraqitet brenda 15 minutave pas orës së përcaktuar për fillimin e mbledhjes, apo në rastin kur ai nuk dëshiron ta drejtojë atë, si kryetar i mbledhjes do të veprojë cdo Person apo Drejtor, që do të caktohet nga Drejtorët për të drejtuar mbledhjen, përveç rastit kur Ortakët pjesëmarrës në mbledhje zgjedhin një Person tjetër për të drejtuar mbledhjen në fjalë.
60. Kryetari i mbledhjes ka të drejtë që, me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme ku merr pjesë kuorumi i nevojshëm (rast në të cilin drejton mbledhjen), të caktojë vazhdimin e mbledhjes në një/disa ditë të tjera në vende të tjera, por në këto mbledhje nuk mund të diskutohet mbi asnjë çështje tjetër, përveç atyre të lëna të pambaruara në mbledhjen e parë. Në rastin kur një mbledhje, apo një vazhdimi i saj, caktohet të zhvillohet pas 14 ditëve, apo pas një periudhe me të gjatë, njoftimi për zhvillimin e saj duhet të kryhet në të njëjtën mënyrë si njoftimi i mbledhjes fillestare. Përveç këtij rasti, nuk është e nevojshme të bëhet njoftimi i shtyrjes së mbledhjes apo i çështjeve që do të diskutohen në të.

61. Drejtorët kanë të drejtë të anulojnë apo të shtyjnë çdo mbledhje të thirrur në mënyrë të rregullt, përvec mbledhjeve të thirrura me kërkesë të Ortakëve sipas kushteve të përcaktuara në Nenet e këtij Statuti. Anullimi apo shtyrja e mbledhjes mund të bëhet nga Drejtorët me apo pa asnjë arsye, duke i njoftuar Ortakët me shkrim për këtë. Shtyrja mund të jetë për një periudhë të caktuar apo të pacaktuar, në varësi të vendimit të Drejtorëve.
62. Për çdo çështje e hedhur në votim në mbledhjen e një Asambleje të Përgjithshme do të votohet duke ngritur dorën, përvec rastit kur një apo më shumë Ortakë të pranishëm personalisht, apo të përfaqësuar me prokurë, do të kërkojnë votim të fshehtë. Drejtuesi i mbledhjes deklaron miratimin e çështjes së hedhur në votim, me shumicë të vecantë apo unanimisht, apo rrëzimin e saj dhe e paraqet vendimin e marrë në Librin e regjistrimit të Procedurave të Shoqërisë. Pasqyrimi i vendimit të Asamblesë në librin e sipërpërmendur përbën provë të plotë të faktit, pa qenë e nevojshme të vërtetohet numri apo pjesët e votave pro, apo kundër atij vendimi.
63. Nëse votimi i fshehtë kërkohet në mënyrë të rregullt, ai do të zhvillohet në mënyrën që përcakton drejtuesi i mbledhjes dhe vendimi i dalë nga ky votim do të përbëjë vendimin e marrë nga mbledhja në fjalë.
64. Në rastin e barazimit të votave, si në rastin e votimit me ngritjen e dorës, apo me votim të fshehtë, drejtuesi i mbledhjes ka të drejtë të vendosë zhvillimin e një votimi të dytë, ose vota e tij është përfundimtare.
65. Në rastet kur kërkohet të bëhet një votim i fshehtë për zgjedhjen e drejtuesit të takimit apo për vazhdimin e mbledhjes në një ditë tjetër, votimi duhet të bëhet menjëherë. Votimi i kërkuar për çdo çështje tjetër do të kryhet në kohën e përcaktuar nga drejtuesi i mbledhjes.

VOTAT E ORTAKËVE

66. Ortakët që kanë të drejtë apo të cilëve u është vendosur kufizim mbi një Kuotë dhe që janë të pranishëm në mbledhje personalisht, apo përfaqësohen me prokurë, kanë të drejtë të ngrenë dorën për të votuar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, ku secili prej tyre ka një votë. Në rastin e votimit të fshehtë, çdo Ortak i pranishëm, apo i përfaqësuar me prokurë, ka të drejtë të një vote për çdo Kuotë që zotëron.
67. Në rastin kur disa Ortakë zotërojnë së bashku një Kuotë, vota e Ortakut më të vjetër që ofron një votë, personalisht apo nëpërmjet autorizimit me prokurë, do të pranohet duke përjashtuar votat e Ortakëve të tjerë. Për efekt të këtij Neni, vjetërsia do të përcaktohet nga vendi sipas rradhës së regjistrimit të emrit në Regjistër.
68. Një ortak i sëmurë psiqikisht, apo të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, duke u shpallur si i papërgjegjshëm nga një vendim Gjykate, mund të votojë, ose duke ngritur dorën ose me votim, nëpërmjet Këshillit të Kujdestarisë apo një personi tjetër me funksionin e Këshillit të Kujdestarisë, të caktuar nga Gjykata si

kujdestar të tij, të cilët mund të votojnë për llogari të Ortakut në fjalë të pajisur me prokurë.

69. Asnjë Ortak nuk ka të drejtë të votojë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deri në momentin që të gjitha shumat e vendosura si interes mbi kuotën, nëse ka, apo shumat e tjera të detyrueshme për t'u paguar prej tij në lidhje me Kuotat që i japin të të drejtë e vote të jenë shlyer plotësisht nga Ortaku në fjalë.
70. Në një votimi të fshehtë mund të votohet personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të pajisur me autorizim.
71. Dokumenti ku pasqyrohet autorizimi duhet të jetë i shkruar me shkrim dore nga ana e autorizuesit, ose avokatit të tij, të autorizuar rregullisht për të kryer këtë veprim, apo nëse autorizuesi është një korporatë, autorizimi kryhet ose duke vendosur Vulën, ose me nënshkrimin e nepunësit apo avokatit të autorizuar rregullisht. I autorizuari jo domosdoshëmrish duhet të jetë Ortak i Shoqërisë.
72. Dokumenti i autorizimit mund të ketë formë të çfarëdoshme, ose çdolloj forme, të përcaktuar nga Drejtorët.
73. Dokument në të cilin pasqyrohet autorizimi konsiderohet se i jep të autorizuarit tagrin për të këkuar apo për t'u bashkuar në kërkesën për kreyerjen e një votimi.
74. Vendimi me shkrim, i nënshkruar nga të gjithë Ortakët që kanë të drejtë për të marrë njoftim për zhvillimin e mbledhjet të përgjithshme të Shoqërisë, të marrin pjesë dhe të votojnë në to, (apo në rastin e korporatave, nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar sipas rregullave) do të jenë po aq të vlefshme dhe efektive sa po të ishin marrë në një mbledhje të përgjithshme të Shoqërisë së mbledhur dhe mbajtur sipas rregullave.

KORPORATAT QË VEPROJNË GJATË TAKIMEVE NËPËRMJET PËRFAQËSUESVE

75. Cdo Korporatë, e cila është Ortak apo një Drejtor ka të drejtë që nëpërmjet vendimit të drejtorëve të saj, apo të një organi tjetër drejtues, të autorizojnë një Person që ajo e mendon të përshtatshëm, që të veprojë si përfaqësues i saj në çdo takim të Shoqërisë, apo të mbajtësve të një Klase, apo të Drejtorëve, apo të një Këshilli Drejtorësh dhe ky Person i autorizuar ka të drejtë të ushtrojë të njëjtat pushtete (për llogari të korporatës që ai përfaqëson), që do të gëzonte ajo korporatë po të ishte një Ortak individual apo Drejtor.

DREJTORËT

76. Emri(at) e Drejtorit(ëve) do të përcaktohen ose me shkrim nga një shumicë (ose në rastin e një nënshkruesi të vetëm, nga ai nënshkrues) e, apo e zgjedhur në një takim të nënshkruesve të Aktit të Themelimit.
77. Shoqëria ka të drejtë që me anë të një Vendimi të Zakonshëm të caktojë si Drejtor një Person fizik apo një korporatë. Drejtorët kanë të drejtë që, me shumicën e Drejtorëve të pranishëm dhe që gëzojnë të drejtën për të votuar në takimin përkatës të Bordit të Drejtorëve, të caktojnë disa persona fizikë apo korporata të tjera për të vepruar si drejtor (ë) në rastet e parashikuara në dispozitat e tjera të këtij Statuti.
78. Sipas këtyre Neneve, Drejtori do të qëndrojë në pozicionin e tij derisa të largohet nga ky pozicion me anë të një Vendimi të Zakonshëm.
79. Herë pas here Shoqëria mund të përcaktojë numrin maksimal dhe minimal të Drejtorëve që duhet të caktohen me anë të një Vendimi të Zakonshëm, por derisa maksimumi dhe minimumi i mësipërm të jetë përcaktuar si mësipër, numri minimal i Drejtorëve do të jetë një dhe numri i maksimal do të jetë i pakufizuar.
80. Paga e Drejtorëve mund të përcaktohet nga Drejtorët ose me anë të një Vendimi të Zakonshëm.
81. Për Drejtorët nuk do të ketë asnjë kufizim për zotërimin e Kuotave, përveçse kur është vendosur ndryshe me një Vendim të Zakonshëm.
82. Drejtorët kanë të drejtë që në çdo moment dhe herë pas here të caktojnë një person fizik apo një korporatë në pozicionin e Drejtorit, si në rastin e mbetjes së vendit vakant, ashtu edhe si një Drejtor shtesë. Kjo, gjithmonë duke respektuar numrin maksimal të Drejtorëve (nëse ka) të përcaktuar nëpërmjet një Vendimi të Zakonshëm.

ZËVENDËSI I DREJTORIT APO PËRFAQËSUESI

83. Çdo Drejtor ka të drejtë që, me anë të një dokumenti të shkruar, të caktojë një Person tjetër që ta zëvendësojë atë, për një kohë të caktuar në aktin e emërimit. Zëvendësuesi do të ketë të drejtë të nënshkruajë Vendime me shkrim në emër të Drejtorit që e ka caktuar dhe të veprojë në vend të Drejtorit në çdo takim të Drejtorëve, në të cilat ky i fundit nuk ka mundësi të marrë pjesë. Çdo zëvendësues do të ketë të drejtë që të marrë pjesë në votime në mbledhjet e Drejtorëve si Drejtor në rastet kur Drejtori që e ka caktuar atë nuk merr pjesë personalisht. Në rastin kur zëvendësuesi është vetë Drejtor, përveç votës që ai vetë ka, do të ketë edhe një votë tjetër në emër të Drejtorit që ai zëvendëson. Në çdo moment Drejtori ka të drejtë të anulojë me shkrim emërimin e zëvendësuesit të caktuar prej tij. Zëvendësuesi i caktuar në këtë rast nuk do të jetë nëpunës i Shoqërisë dhe do të konsiderohet se është agjent i i Drejtorit që e ka caktuar atë. Paga e zëvendësuesit do të jetë i merret nga paga e Drejtorit që e ka caktuar atë dhe shuma do të përcaktohet me marrëveshje mes tyre.
84. Çdo Drejtor mund të caktojë një Person, qoftë ky i fundit Drejtor apo jo, të veprojë si i autorizuari i atij Drejtori për të marrë pjesë dhe për të votuar në emër

të tij në mbledhjen apo mbledhjet e Drejtorëve, ku vetë Drejtori nuk mund të jetë i pranishëm, duke vepruar në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Drejtori në fjalë, ose në mungesë të këtyre udhëzimeve, të veprojë në bazë të kompetencave të përcaktuara në autorizim. Dokumenti i autorizimit duhet të jetë i shkruar me dorë nga Drejtori që lëshon autorizimin dhe mund të hartohet në çdo formë të përgjithshme apo të zakonshme, apo në formën e përcaktuar nga Drejtorët dhe duhet t'i dorëzohet drejtuesit të mbledhjes së Drejtorëve për të cilën është e vlefshëm ky autorizim, apo ku do të përdoret për herë të parë, përpara fillimit të mbledhjes.

TË DREJTAT DHE DETYRAT E DREJTORËVE

85. Veprimtaria e Shoqërisë do të menaxhohet nga Drejtorët në bazë të Ligjit, këtyre dispozitave dhe Vendimeve të miratuara në Mbledhjet e Përgjithshme. Drejtorët kanë të drejtë të paguajnë të gjitha shpenzimet e nevojshme për themelimin dhe regjistrimin e Shoqërisë dhe mund të ushtrojnë të gjitha të drejtat e saj. Drejtorët kanë të drejtë të fillojnë në emër të Shoqërisë likuidimin apo ndonjë procedurë tjetër paaftësie paguese në përputhje me Ligjin. Asnjë Vendim i miratuar nga Shoqëria në një mbledhje të përgjithshme nuk mund të shfuqizojë një veprim të mëparshëm të Drejtorëve, i cili do të ishte vlefshëm nëse ai vendim nuk do të ishte miratuar.
86. Drejtorët kanë të drejtë që herë pas here të caktojnë në vendin e tyre çdo Person, qoftë ky Drejtor apo jo, që ata mendojnë se është i nevojshëm për administrimin e Shoqërisë. Postet që mund të zërë ky Person mund të jenë posti i presidentit, por jo vetëm ky, një apo më shumë zv-presidentë, thesarnbajtës, ndihmës-thezarnbajtës, menaxher apo kontrollor. Ky emërim do të jetë për një periudhë dhe me një pagë (qoftë kjo në formën e rrogës, mbajtjes së komisionit, apo pjesëmarrjes në përfitime, apo pjesërisht në njërën mënyrë dhe pjesërisht në tjetrën) dhe me kompetencat dhe detyrat që Drejtorët do t'i mendojnë si të përshtatshme. Personi i emëruar si mësipër mund të shkarkohet nga Drejtorët, apo nga një Vendim i Zakonshëm i Shoqërisë. Drejtorët kanë të drejtë gjithashtu të caktojnë, me të njëjtat kushte, një apo më shumë prej tyre në postin e drejtorit ekzekutiv, por një emërim i tillë do të përcaktojë *ipso facto* nëse ndonjë drejtor ekzekutiv pushon së qëni për ndonjë shkak Drejtor, apo nëse Shoqëria me një Vendim të Zakonshëm vendos që qëndrimi i tij në këtë post të përfundojë.
87. Drejtorët mund të caktojnë një Sekretar (dhe në është e nevojshme një ndihmës-Sekretar apo asistent-Sekretar), i cili do ta mbajë postin për aq kohë, me pagën, me kushtet dhe me kompetencat që ata e konsiderojnë të përshtatshme. Çdo Sekretar apo ndihmës-Sekretar i caktuar nga Drejtorët mund të shkarkohet nga Drejtorët apo nga një Vendim i Zakonshëm i Shoqërisë.
88. Drejtorët mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre këshillave të përbërë nga një anëtar apo disa anëtarë të organi të tyre sa ata e konsiderojnë të përshtatshme: çdo këshill i formuar në këtë mënyrë do të ushtrojë të gjitha kompetencat që i janë deleguar konform rregullave që mund t'i vendosen nga Drejtorët.

89. Drejtorët kanë të drejtë që herë pas here dhe në çdo moment, nëpërmjet prokurës, qoftë me vulë apo me nënshkrim, të caktojnë një Shoqëri, firmë, Person apo grup Personash, qoftë të emëruar në mënyrë direkte apo indirekte nga Drejtorët, që të jenë avokati apo avokatët e shoqërise për këto qëllime dhe me këto kompetenca, autoritet dhe diskrecion, (pa tejkaluar kompetencat që gëzojnë apo ushtrojnë Drejtorët sipas këtyre Neneve) për një periudhë të caktuar dhe në kushtet që ata i konsiderojnë të përshtatshme. Një prokurë e tillë mund të përmbajë, nëse Drejtorët e mendojnë të përshtatshme, dispozita të caktuara për mbrojtjen dhe përfitimin e personave që negociojnë me avokatët në fjalë dhe gjithashtu, ato mund t'i njohin avokatëve të drejtën që t'u delegojnë personave të tjerë të gjitha apo një pjesë të kompetencave, autoritetit, apo diskrecionit që ata mbajnë.
90. Drejtorët mundet që herë pas here të kujdesen për menaxhimin e çështjeve të Shoqërisë në mënyrën që ata e shohin të përshtatshme dhe përmbajtja e tre Neneve të mëposhtme nuk i kufizon kompetencat e përgjithshme që iu njihen atyre nga ky Nen.
91. Drejtorët mundet që herë pas here dhe në çdo moment, të krijojnë këshille, borde lokale apo agjenci për menaxhimin e ndonjë prej çështjeve të Shoqërisë dhe mund të caktojnë personat që ata i mendojnë si të përshtatshëm që të jenë anëtarë të këtyre këshillave, apo bordeve lokale. Drejtorët mund të caktojnë cdo manaxher apo agjent të shoqërisë dhe të përcaktojnë pagën për çdo Person të tillë.
92. Drejtorët kanë të drejtë që herë pas here dhe në çdo kohë t'i delegojnë këshillave apo bordeve lokale të sipërpërmendura, menaxherëve, apo agjentëve çdo kompetencë, autoritet, apo diskrecion që ata (Drejtorët) gëzojnë. Drejtorët mund t'i autorizojnë anëtarët e këtyre bordeve, apo njërin prej tyre, që të plotësojnë vendet bosh dhe të veprojnë pavarësisht nga vendet bosh. Një emërim apo delegim i tillë bëhet me kushtet dhe për peridhën që Drejtorët e mendojnë të përshtatshme. Drejtorët kanë të drejtë që në çdo moment të shkarkojnë çdo Person të emëruar si mësipër, apo të anullojnë apo të ndryshojnë të drejtat e deleguara në mënyrën e përshkruar mësipër, por anulimi apo ndryshimi i mësipërm është i vlefshëm për asnjë Person që vepron në mirëbesim dhe që nuk është njoftuar për një anulim apo ndryshim të tillë.
93. Çdo Person të cilit i janë deleguar kompetenca në kushtet e mësipërme, mund të autorizohet nga Drejtorët që të nën-delegojë të gjitha apo ndonjë nga kompetencat, autoritetet, apo diskrecionet që i janë njohur.

KOMPETENCAT E DREJTORËVE PËR TË MARRË HUA

94. Drejtorët kanë të drejtë të ushtrojnë të gjitha kompetencat e Shoqërisë për të marrë hua, për të vënë në hipotekë apo për të vënë barrë mbi sipërmarrjet e saj, pronat, kapitalin apo ndonjë pjesë të tij, të emetojnë obligacione, obligacione të pagarantuara dhe letra të tjera me vlerë, në çdo rast që Shoqëria merr hua, apo si garanci për një borxh, përgjegjësi apo detyrim që ka Shoqëria, apo ndonjë person i tretë.

VULA

95. Vula nuk duhet të vihet mbi asnjë dokument, përveç rastit kur këtë e vendosin Drejtorët me vendim. Një vendim i tillë mund të merret përpara apo pas vendosjes së Vulës dhe në rastin kur jepet më pas, mund të bëhet në një formë të përgjithshme për ratifikimin e disa dokumentave të vulosura në një datë të mëparshme. Vula do të vendoset në prani të Drejtorit, të Sekretarit (apo ndihmës-Sekretarit), apo në prani të një apo më shumë Personave që mund të caktojnë Drejtorët për këtë qëllim. Çdo Person i caktuar si mësipër duhet të nënshkruajë çdo dokument në të cilin është vendosur vula në prani të tyre.
96. Shoqëria mund të mbajë një kopje të Vulës në vendet dhe shtetet që Drejtorët mund të caktojnë dhe me këtë kopje të Vulës nuk duhet të vuloset asnjë dokumenti, me përjashtim të rastit kur Drejtorët, me anë të një vendimi të tyre vendosin ta lejojnë një gjë të tillë. Një vendim i tillë i Drejtorëve mund të merret përpara, apo pas vulosjes së një dokumenti me kopjen e Vulës. Nëse jepet më pas, forma e vendimit mund të jetë e përgjithshme dhe mund të ratifikojë disa dokumenta të vulosura me kopjen e Vulës në një datë të mëparshme. Vula faksimile mund të përdoret në prani të Personit, apo Personave që Drejtorët kanë caktuar për këtë qëllim dhe Personi, apo Personat e mësipërm duhet të nënshkruajnë çdo dokument, në të cilin vendoset Vula faksimile në prani të tyre. Vulosja dhe nënshkrimi i përmendur sa më lart do të ketë të njëjtin kuptim dhe efekt, sikur Vula të ishte vënë në prani të vetë Drejtorit, Sekretarit (apo asistenti i Sekretarit), apo në prani të ndonjë apo më tepër personave të caktuar nga Drejtorët për këtë qëllim dhe të ishte nënshkruar po nga ata.
97. Pavarësisht nga sa më lart, Sekretari apo ndihmës-Sekretari ka të drejtë të vulosë me Vulën, apo faksimilen e Vulës, çdo dokument për efekt të vërtetimit të njësimi me dokumentin origjinal, por në asnjë rast një veprim i tillë nuk krijon ndonjë detyrim për Shoqërinë.

SHKARKIMI I DREJTORËVE

98. Posti i Drejtorit do të lirohet, nëse Drejtori:
- (a) falimenton apo bën ndonjë marrëveshje apo ujdj me kreditorët e tij.
 - (b) vdes apo deklarohet mendërisht i papërgjegjshëm.
 - (c) heq dorë nga detyra duke njoftuar për këtë Shoqërinë me shkrim.
 - (d) largohet nga posti nëpërmjet një vendimi të zakonshëm; ose

- (e) largohet nga detyra me anë të një njoftimi që i dërgohet atij në adresën e tij më të re të njohur dhe që nënshkruhet nga të gjithë bashkë-drejtorët e tjerë (jo më pak se dy në numër).

PROCEDURAT E DREJTORËVE

99. Drejtorët mund të takohen me njëri-tjetrin (brenda ose jashtë Cayman Islands) me qëllim kryerjen e aktiviteteve, shtyrjen apo organizimin e takimeve dhe procedurave të tyre, në kushtet që ata e c shohin të arsyeshme. Për çështjet që diskutohen në çdo takim vendoset me shumicë votash. Në rast pabarazie votash kryetari do të ketë të drejtën e një vote të dytë. Drejtori, Sekretari apo ndihmës-Sekretari, me kërkesën e Drejtorit, ka të drejtë të thërrasë në çdo kohë mbledhjen e Drejtorëve.
100. Drejtori mund të marrë pjesë në çdo mbledhje të Drejtorëve apo të ndonjë këshilli të caktuar nga Drejtorët, anëtar i të cilit është, nëpërmjet telefonit, apo mjeteve të tjera të komunikimit, të cilat mundësojnë që të gjithë pjesëmarrësit në takim të mund të komunikojnë me njëri-tjetrin lirisht. Kjo pjesëmarrje konsiderohet se garanton praninë e personave në atë takim.
101. Kuorumi i nevojshëm për marrjen e vendimeve që lidhen me transaksionet nga Drejtorët përcaktohet nga Drejtorët dhe, përveç rastit kur një kuorum i tillë është përcaktuar, nëse janë dy ose më shumë Drejtorë, kuorumi do të jetë dy, dhe nëse do të jetë një Drejtor kuorumi do të jetë një. Drejtori që përfaqësohet nga një Person me autorizim, apo nga një Drejtor zëvendësues, konsiderohet se është i pranishëm në çdo takim për sa i përket formimit apo jo të kuoromit të nevojshëm.
102. Nëse një Drejtor ka një mënyrë ose një tjetër, një interes direkt apo indirekt në lidhje me një kontratë apo propozim kontrate që do të lidhet me Shoqërinë, duhet të deklarojë natyrën e interesit të tij në mbledhjen e Drejtorëve. Njoftimi që u bëhet Drejtorëve nga një Drejtor për faktin se ky i fundit është anëtar i ndonjë Shoqërie, apo firme tjetër dhe se mund të konsiderohet si i interesuar në ndonjë kontratë që mund të lidhet mes saj dhe Shoqërisë, konsiderohet si deklaratë e mjaftueshme për ekzistencën e interesit që mund të ketë Drejtori në fjalë në lidhje me një kontratë që mund të lidhet në këto kushte. Drejtori mund të votojë në lidhje me çdo kontratë, propozim-kontrate, apo marrëveshje pavarësisht nga fakti që ai mund të ketë interes në të dhe në këtë rast vota e tij do të numërohet dhe ai do të llogaritet në kuorum në çdo takim paraprak të Drejtorëve, në të cilin do të diskutohet paraprakisht kontrata, propozimi për kontratë, apo marrëveshja në fjalë.
103. Një Drejtor mund të mbajë një post tjetër apo vend përfitimi nën kompaninë (me përjashtim të zyrës së auditorit) në ndërthurje me zyrën e tij të Drejtorit për një periudhë të tillë dhe në kushte të tilla (sa i përket shpërblimit dhe në rast të kundërt) sikundër mund ta përcaktojnë drejtorët dhe asnjë Drejtor apo Drejtor që ka për qëllim nuk do të përjashtohen nga zyra prej kontraktimit me Kompaninë ose në lidhje me mbajtjen e tij të një zyre tjetër të tillë apo vendi përfitimi apo si shitës, blerës apo përndryshe e as që ndonjë kontratë e tillë apo marrëveshje e lidhur nga apo në emër të Kompanisë në të cilën cilido Drejtor është në ndonjë

mënyrë i interesuar, të jetë e detyrueshme për tu mënjeluar, as as cildo Drejtor i cili duke kontraktuar apo duke shprehur interesin të jetë përgjegjës për llogari të kompanisë për ndonjë përfitim të përmbushur nga cdo kontratë apo marrëveshje e tillë për arsye se Drejtori e mban një zyrë të tillë apo për shkak të arsyeve të besimit të krijuar që aty. Një Drejtor, pavarësisht nga interesi i tij, mund të numërohet në kuorumin e pranishëm në cdo takim të Drejtorëve në të cilin ai apo ndonjë Drejtor tjetër, janë caktuar që të mbajnë ndonjë zyrë të tillë apo vend përfitimi nën Kompaninë apo ku kushtet e një funksioni të tillë janë rregulluar dhe aim und të votojë në një funksion apo marrëveshje të tillë.

104. Cdo Drejtor mund të veprojë vetëm apo nëpërmjet firmës së tij, duke shfrytëzuar aftësitë profesionale për Shoqërinë dhe ai, apo firma e tij kanë të drejtë të paguhet për shërbimin profesional që ofrojnë, si të mos ishte Drejtori i Shoqërisë, me kusht që në asnjë rast këto shërbime të mos përbëjnë auditimin e Shoqërisë.

105. Drejtorët duhet të vendosin që në libra apo në dosje me fletë të pangjitura të mbahen procesverbalet e:

(a) të gjithë emërimet e nëpunësve të bëra nga Drejtorët.

(b) emrat e Drejtorëve të pranishëm në mbledhjet e Drejtorëve apo në këshillat e Drejtorëve, dhe

(c) të gjitha vendimet dhe procedurat e ndjekura gjatë mbledhjes së sambleve të Shoqërisë, apo mbledhjeve të Drejtorëve, apo Këshillave të Drejtorëve.

106. Kur drejtuesi i mbledhjes së Drejtorëve nënshkruan procesverbalin e këtyre mbledhjeve, konsiderohet se ato janë zhvilluar në mënyrë të rregullt, pavarësisht se në to mund të mos kenë marrë pjesë të gjithë Drejtorët, apo gjatë mbledhjes mund të ketë patur ndonjë defekt teknik.

107. Një vendim i nënshkruar nga të gjithë Drejtorët që kanë të drejtë të njoftohen për zhvillimin e mbledhjes së Drejtorëve, përfshirë këtu edhe vendimet e firmosura nga zëvendësuesit e Drejtorëve, të caktuar sipas rregullave (të përshkruara në dispozitat mbi caktimin e zëvendësuesve), do të konsiderohet po aq i vlefshëm dhe efektiv si të ishte miratuar në një mbledhje të Drejtorëve, të thirrur dhe të zhvilluar sipas rregullave. Kur një vendim pasqyrohet në disa dokumenta, secili prej tyre duhet nënshkruar nga Drejtori, apo zëvendësuesi i tij.

108. Drejtorët mund të veprojnë pavarësisht nga ndonjë vend vakant në organin e tyre, por në rastin kur numri i mbetur është më i vogël se ai që parashikohet në këto Nene, këta Drejtorë mund të veprojnë vetëm për rritjen e numrit të tyre, apo për mbledhjen e një Asambleje të Përgjithshme të Shoqërisë dhe jo për ndonjë rast tjetër.

109. Drejtorët mund të zgjedhin një kryetar të mbledhjeve të tyre dhe të përcaktojnë periudhën për të cilën ky i fundit do të mbajë këtë post, por në rastin kur një kryetar i tillë nuk zgjidhet, apo në rastin kur kryetari nuk paraqitet në mbledhje

pas 15 minutash nga ora e caktuar për të filluar mbledhja, Drejtorët e pranishëm mund të zgjedhin një prej tyre të drejtojë mbledhjen.

110. Një këshill i formuar nga Drejtorët, në përputhje me rregullat e vendosura prej tyre, mund të zgjedhë një kryetar të mbledhjeve të tij. Nëse kryetari nuk zgjidhet, apo në rastin kur kryetari nuk paraqitet në mbledhje pas 15 minutash nga ora e caktuar për të filluar mbledhja, anëtarët e këshillit mund të zgjedhin një prej tyre të drejtojë mbledhjen.
111. Këshilli i krijuar nga Drejtorët mund të mblidhet apo t'i shtyjë mbledhjet e tij, sa herë që e konsideron të përshtatshme. Në bazë të rregullave të përcaktuara nga Drejtorët, çështjet që diskutohen në mbledhjet e Këshillit duhet të miratohen me shumicën e votave të pjesëmarrësve dhe në rastin e barazimit, kryetari ka të drejtën e një vote të dytë.
112. Të gjitha veprimet e kryera nga një mbledhje e Drejtorëve, e Këshillave të krijuar prej tyre, apo nga cdo person që vepron si Drejtor, edhe pse më vonë mund të vërtetohet se ka pasur një defekt në emërimin e atij Drejtori, apo Personi për të vepruar si mësipër, apo nëse vërtetohet se ata apo njëri prej tyre ishte shkarkuar, do të konsiderohen po aq të vlefshme si të ishin kryer nga Persona të emëruar rregullisht dhe të kualifikuar për të qenë Drejtorë.

DIVIDENDET

113. Drejtorët kanë të drejtë që, në bazë të të drejtave apo kufizimeve mbi Kuotat, herë pas here të shpërndajnë dividendë (përfshirë këtu dividendët e përkohshëm), të shpërndajnë Kuotat e tjera të emetuara dhe të autorizojnë pagesa nga fondi i Shoqërisë, i lënë për këtë qëllim sipas rregullave përkatëse.
114. Shoqëria, me anë të Vendimeve të Thjeshta, mund të shpërndajë dividend, duke u bazuar në të drejtat apo kufizimet e ndryshme mbi Kuotat, por në asnjë rast shuma e dividendëve të shpërndarë nuk duhet të kalojë shumën e përcaktuar nga Drejtorët.
115. Drejtorët kanë të drejtë që përpara se të shpallin apo ndajnë dividendët, të kalojnë në fondet e gatshme për shpërndarje, në përputhje me dispozitat ligjore, shumat që ata i konsiderojnë si të përshtatshme për t'i mbajtur si rezervë apo rezerva, të cilat do të përdoren sipas vendimeve të marra nga Drejtorët në diskrecionin e tyre të plotë, në raste të paparashikuara, për barazimin e dividendëve, apo për cdo rast tjetër në të cilin këto fonde mund të përdoren në mënyrën e duhur. Drejtorët, në diskrecionin e tyre të plotë vendosin nëse këto fonde do të përdoren për veprimtarinë e Shoqërisë, apo do të investohen në fushat ku ata e shohin të përshtatshme.
116. Dividendët paguhën në mënyrën që Drejtorët e mendojnë si të përshtatshme. Nëse paguhet me cek, ai do të dërgohet me postë në adresën e regjistruar të Ortakut apo të Personit të legjitimuar. Në rastin e disa Ortakëve që zotërojnë sëbashku një apo disa Kuota, ceku do të dërgohet në adresën e regjistruar të cilitdo prej tyre, apo të Personit të legjitimuar, apo në adresën që ata mund të kërkojnë.

Ceku do t'i paguhet Personit, apo Ortakut të cilit i është dërguar, me kërkesën e tij, apo në rastin e disa Ortakëve që zotërojnë sëbashku Kuota, me kërkesën e Personit që ata caktojnë.

117. Kur dividendët u shpërndahen Ortakëve sipas dispozitave të mësipërme, Drejtorët mund ta bëjnë pagesën e tyre me para në dorë, apo në monedha.
118. Të gjithë dividendët, në bazë të të drejtave apo kufizimeve mbi Kuotat, duhet të deklarohen dhe të paguhen në përputhje me shumën e shlyer të Kuotës, por për sa kohë asnjë nga Kuotat nuk është shlyer, dividendët mund të deklarohen dhe të paguhen në përputhje me vlerën minimale të Kuotës.
119. Në rastin kur disa Persona janë regjistruar si Ortakë të përbashkët të një Kuote, secili prej tyre mund të lëshojë fatura të vlefshme për dividendë apo para të tjera të pagueshme në bazë të Kuotës.
120. Asnjë dividend nuk mund të llogaritet me interes në ngarkim të Shoqërisë.

LLOGARITË, AUDITIMI, FITIMI VJETOR DHE DEKLARIMI

121. Librat e llogarive që lidhen me veprimtarinë e Shoqërisë do të mbahen në mënyrën e përcaktuar herë pas here nga Drejtorët.
122. Librat e llogarive do të mbahen në Zyrë, ose në vendin apo vendet e tjera që mund Drejtorët mund të konsiderojnë si të përshtatshëm dhe duhet të jenë të hapura në cdo moment për inspektimin e tyre.
123. Drejtorët duhet të përcaktojnë herë pas here nëse, në c'masë, kur, ku dhe në c'kushte apo rregulla Librat e Shoqërisë, apo njëri prej tyre mund t'u vihen në dispozicion Ortakëve jo Drejtorë për t'i inspektuar. Asnjë Ortak (që nuk është Drejtor) nuk ka të drejtë të inspektojë asnjë llogari, libër apo dokument të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara në ligj, kur lejohet nga Drejtorët, apo kur vendoset me anë të një vendimi të zakonshë.
124. Llogaritë që lidhen me veprimtarinë e Shoqërisë mund të auditohen vetëm nëse kështu vendosin Drejtorët, në rastin kur mbaron viti financiar dhe parimet mënyrës së llogaritjeve do të përcaktohen nga Drejtorët.
125. Drejtorët duhet të përgatisin, apo të vendosin të përgatitën, cdo vit, fitimin vjetor dhe deklarimin e tij në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe duhet të dërgojnë një kopje të tyre për t'u regjistruar në Regjistrin e Shoqërisë në Cayman Island.

AKUMULIMI I REZERVAVE

126. Në përputhje me Ligjin, Drejtorët kanë të drejtë të:

(a) vendosin të akumulojnë një shumë si rezervë (përfshirë këtu primin e emetimit të një kuote, rezervën e kapitalit të riblerjes, llogarinë e përfitua apo të humbur), e cila mund të lihet ose jo në dispozicion për t'u shpërndarë,

(b) përcaktojnë shumën e vendosur të ruhet si rezervë për Ortakët në raport me shumën nominale të Kuotave (të shlyera ose jo plotësisht) që ata zotërojnë respektivisht dhe përdorin këtë shumë për llogari të këtyre të fundit për:

- (i) të paguar shumat (nëse ka) për periudhën që nuk kanë shlyer Kuotat e zotëruara respektivisht prej tyre, ose
- (ii) të paguar plotësisht Kuotat e paemetuara apo kreditë me vlerë nominale të barabartë me atë shumë, dhe t'ua ndajnë Kuotat ose borxhet, të konsideruar si të shlyera plotësisht, Ortakëve (ose personave që ata caktojnë) në ato raporte, ose pjesërisht në njërin dhe pjesërisht në mënyrën tjetër. Por, llogaria e primit të Kuotës, kapitali rezervë për riblerjen dhe përfitimet që nuk janë lënë në dispozicion për t'u shpërndarë, për qëllimet e këtij Neni, mund të përdoren vetëm për pagimin e Kuotave të paemetuar ende, të cilat do t'u shpërndahen Ortakëve, duke u konsideruar sit ë paguara plotësisht.

(c) lidhin cdo marrëveshje që ata e konsiderojnë të nevojshme për të zgjidhur vështirësitë që mund të lindin në ndarjen e rezervës së ruajtur dhe në mënyrë të vecantë, në rastin kur Kuotat apo kreditë mund të ndahen në pjesë, Drejtorët kanë të drejtë, pa asnjë kufizim, të përdorin pjesët që në mënyrën që ata e mendojnë të përshtatshme

(d) autorizojnë një Person të hyjë (për llogari të të gjithë Ortakëve që u intereson) në marrëveshje me Shoqërinë, duke siguruar:

- (i) shpërndarjen Ortakëve, respektivisht, të Kuotave, apo kredive që ata mund të gëzojnë mbi akumulimin, ose
- (ii) pagimin për llogari të Ortakëve nga ana e Shoqërisë (në përputhje me pjesët e tyre respective në rezervat e vendosura për t'u akumuluar) të shumave, apo pjesëve të shumave ende të papaguara për shlyerjen e Kuotave të tyre ekzistuese,

si dhe, cdo marrëveshje të tillë, të lidhur duke pasur këtë autoritet dhe që është e detyrueshme dhe sjell efekte mbi cdo Ortak, dhe

(e) zakonisht të bëjnë cdo gjë dhe të ndërmarrin cdo veprim për të ekzekutuar vendimin.

LLOGARIA PËR VLERËN E KUOTAVE

126. Drejtorët, në përputhje me Ligjin, duhet të vendosin një Llogari për vlerën e Kuotave dhe duhet të derdhin herë pas here në këtë llogari një shumë të barabartë me shumën apo vlerën e primit të paguar për emetimin e Kuotës.

127. Në rastin e blerjes apo të riblerjes së një Kuote, diferenca mes vlerës nominale të saj dhe cmimit të blerjes apo të riblerjes, do të merret nga Llogaria për Vlerën e Kuotave, përvec rastit kur Drejtorët, në diskrecionin e tyre, vendosin që kjo shumë të paguhet nga fitimet e Shoqërisë, ose, nëse lejohet nga Ligji, nga kapitali i saj.

LLOGARIA E INVESTIMIT

128. Drejtorët mund të vendosin llogari të vecanta në librat dhe regjistrat e Shoqërisë (secila si "**Llogari Investimi**") për secilën Klasë, ose sipas rastit, për më shumë se një Klasë. Për secilën Llogari Investimesh do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(a) fitimet nga shpërndarja dhe emetimi i Kuotave të cilësdo Klase, mund të paraqiten në librat e Shoqërisë, në Llogarinë e Investimit të përcaktuar për kuotat e asaj Klase,

(b) asetet, të drejtat, fitimet dhe shpenzimet e bëra për kuotën e cilësdo Klase, mund të përdoren apo të shpërndahen për qëllime llogarie në Llogarinë respektive të Investimit, të krijuar për Kuotat e Klasës përkatëse, të parashikuara nga ky nen,

(c) në rastin kur një aset rrjedh nga një aset tjetër (qoftë me parë në dorë, apo ndryshe), i pari mund të pasqyrohet në librat e Shoqërisë, në Llogarinë e Investimeve nga e cila rridhte aset i tillë me të. Në vlerësimin e çdo investimi rritja apo zvogëlimi i vlerës së këtyre aseteve (apo pjesa kryesore e kësaj rritjeje apo zvogëlimi në vlerë) mund të vendoset në Llogarinë respektive të Investimit,

(d) në rastin kur një i Shoqërisë konsiderohet si i parëndësishëm nga Drejtorët, ai vendoset në një Llogari të vecantë Investimi. Drejtorët, përcaktojnë në diskrecionin e tyre bazën mbi të cilën një aset i tillë do të shpërndahet nëpër Llogaritë e Investimit. Drejtorët kanë të drejtë që herë pas here dhe në çdo moment të ndryshojnë këtë shpërndarje,

(e) kur asetet e Shoqërisë që nuk janë shpërndarë në asnjë Llogari Investimi krijojnë ndonjë përfitim neto, Drejtorët mund t'i shpërndajnë asetet që sjellin këto përfitime neto, në Llogari Investimi, në mënyrën që ata e mendojnë si më të përshtatshme,

(f) Drejtorët përcaktojnë bazën, mbi të cilën do të ndahet nëpër Llogaritë e Investimit, çdo debi, përfshirë këtu edhe shpenzimet, duke përcaktuar edhe kushtet në të cilat më vonë mund të bëhet një rialokim, nëse rrethanat e lejojnë. Drejtorët kanë të drejtë që herë pas here dhe në çdo moment ta ndryshojnë bazën e sipërcituar dhe t'i zbresin shpenzimet e Shoqërisë nga të ardhurat, ose nga kapitali i Llogarive të Investimit

dhe,

(g) Drejtorët kanë të drejtë, që si rezultat i një kredie mbi asetet e ndryshme të Shoqërisë, të transferojnë nga dhe në Llogaritë e Investimeve, nëpërmjet librave të Shoqërisë, në të kundërt, do të lindë një debi, në kushte të ndryshme nga ata të parshikuara nga paragrafi (f), apo në rrethana të ngjashme.

130. Në përputhje me dispozitat ligjore dhe vetëm nëse parashikohet ndryshe nga Nenet e Statutit, asetet e mbajtura në cilëndo Llogari Investimi do të përdoren vetëm në lidhje me Kuotat e Klasës, me të cilën ka lidhje Llogaria e Investimit në fjalë. Asnjë Ortak i një Kuote që i përket një Klase të caktuar nuk mund të ketë pretendime mbi një Kuotë të një Klase tjetër.

NJOFTIMET

131. Çdo njoftim apo dokument që bëhet nga Shoqëria, ose nga Personi që ka të drejtë të njoftojë Ortakët personalisht, apo nëpërmjet postës ajrore, me anë të një letre të parapaguar, drejtuar Ortakut në fjalë në adresën që rezulton e regjistruar në Regjistër, ose në adresën elektronike që Ortaku mund të ketë deklaruar me shkrim me qëllim njoftimin e tij nëpërmjet saj, ose me kabëll, teleks, apo kopje, do të konsiderohet si i rregullt nga Drejtorët. Në rastin e disa Ortakëve që zotërojnë bashkarisht një Kuotë, të gjitha njoftimet do t'i bëhen Ortakut, emri i të cilit figuron i pari në Regjistër dhe nëpërmjet njoftimit të tij, konsiderohet se janë njoftuar edhe bashkëortakët e tjerë.

132. Cdo Ortak i pranishëm, qoftë personalisht, apo i përfaqësuar me autorizim, në një mbledhje të Shoqërisë, konsiderohet në lidhje me cdo çështje, se është njoftuar në mënyrë të rregullt për zhvillimin e mbledhjes dhe kur kërkohet, edhe për çështjet për të cilat do mbahet kjo mbledhje.

133. Çdo njoftim, apo dokument tjetër, nëse dërgohet me:

- (a) postë, quhet se është dorëzuar 5 ditë pas datës së nisjes së letrës,
- (b) faks, quhet se është dërguar kur vërtetohet dërgimi i plotë i tekstit nëpërmjet raportit të printuar nga makineria e faksit,
- (c) shërbim postar rekomandë, quhet se letra ka arritur 48 orë pasi është dorëzuar në shërbimin postar, ose
- (d) postë elektronike, quhet se ka mbërritur menjëherë pas nisjes së mesazhit elektronik.

Për të provuar dërgimin e njoftimit me postë apo me postë rekomandë, mjafton të provohet se letra që përmbante njoftimin, ose dokumenti përmbante

adresën e saktë të marrësit dhe është postuar apo i është dërguar në shërbimin rekomandë sipas rregullave.

134. Çdo njoftim apo dokument i shpërndarë apo i dërguar me postë, apo i lënë në adresën përkatëse të regjistruar te një Ortaku, në përputhje me këto dispozita, pavaresisht faktit se ky Ortak mund të ketë vdekur apo mund të ketë falimentuar dhe faktit nëse Shoqëria ka ose jo njoftim për vdekjen apo falimentimin e tij, do të konsiderohet se është bërë në mënyrë të rregullt, në respekt të Kuotës apo Kuotave që ai mund të zotërojë qoftë si Ortak i vetëm, apo si bashkëortak i saj/tyre me të tjerë. Ky njoftim nuk konsiderohet i rregullt nëse emri i tij, gjatë kohës së shpërndarjes së njoftimit apo dokumentit është hequr nga Regjistri i Ortakëve. Njoftimi i bërë sipas rregullave të mësipërme do të konsiderohet, për të gjitha qëllimet, si shërbim i mjaftueshëm për çdolloj njoftimi apo dokumenti që u drejtohet Personave të interesuar (qoftë individualisht, apo së bashku me të tjerë) mbi Kuoten.
135. Për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë do të njoftohen:
- i. të gjithë Ortakët që zotërojnë Kuota, që kanë të drejtë të njoftohen dhe të cilët kanë depozituar pranë Shoqërisë adresën e tyre, ku të dërgohen njoftimet; dhe
 - ii. çdo Person që gëzon të drejta mbi një Kuote si rezultat i vdekjes apo e falimentimit të një Ortaku, i cili ka të drejtë të njoftohet vetëm në rastin e vdekjes apo të falimentimit të Ortakut në fjalë.

Asnjë person tjetër nuk ka të drejtë të njoftohet për zhvillimin e mbledhjeve të Asamblesë.

DËMSHPËRBLIMI

136. Çdo drejtor (për qëllimet e këtij Neni, këtu përfshihet edhe zëvendësuesi i Drejtorit, i emëruar sipas parashikimeve të këtyre dispozitave), Sekretar, ndihmës Sekretar, nëpunës tjetër i Shoqërisë, apo personat që i përfaqësojnë ata (secili "**Person i dëmtuar**"), (duke mospërfshirë në këtë kategori personat që bëjnë auditimin e Shoqërisë), gëzon të drejtën që momentalisht dhe kohe pas kohe në Shoqëri (duke përjashtuar auditorët e shoqërisë), si dhe përfaqësuesit personale të tyre (te quajtur persona të kompensuar), do të kompensohen dhe do jënë të siguruar për pronat dhe fondet e shoqërisë ndaj çdo veprimi, procedimi, shpenzimi, kostojë, akuze, humbje, dëmtimi apo përgjegjësie të ndodhur nga ky person i kompensuar, pavaresisht nga arsyeja e mungesës së ndershmerisë së këtij personi, paramendimi, kundravajtjes apo mashtrimit, me ose pa lidhje me biznesin apo punët e shoqërisë (duke përfshirë këtu rezultatit si rast i ndonjë gabimi apo gjykimi) apo gjatë veprimtarisë së tij, detyrës, autoritetit apo diskrecionit, duke përfshirë pa paragjykuar përgjithësimet e mësipërme; shpenzimet, kostot, humbjet apo përgjegjësitë të shkaktuara nga ky person në mbrojtje (pavaresisht rezultatit të

suksesshem apo jo) te cdo procedure civile qe ka te beje me shoqerine apo ceshtjet e saj, perpara cdo gjykate si ne ishujt Cayman apo dhe ne cdo vend tjeter.

137. Asnje person i kompensuar nuk do te jete pergjegjes per:

- (a) veprimet, marrjet, neglizhimet, kundravajtjet apo gabimet e cdo drejtori apo agjenti apo nepunesi te shoqerise,
- (b) humbjet apo defektet ne lidhje me titujt e pronesis se shoqerise,
- (c) pajftueshmerine apo pasigurine mbi investimet ku do te drejtohet shoqeria;
- (d) humbjet e ndodhura nga bankat, agjentet apo persona te ngjashem,
- (e) humbjet e ndodhura nga neglizhenca, kundravajtja mashtrimi gjate detyres, humbja e besimit, gabimit ne gjykim mbi pjesen e personit te kompensuar,
- (f) cdo humbje, dëmtim, fatkeqesi qe mund te ndodhe nga ekzekutimi i detyres, pushtetit, diskrecionit te zyres se ketyre personaeve apo ne lidhje me to,

vetem nese keto ndodhin nga mungesa e ndershmerise, kokefortesise, kundravajtes, mashtrimit te vete ketij personi.

MOSNJOHJA E TRUSTEVE

138. Në përputhje me këtë dispozitë, asnjë Person nuk do të njihet nga Shoqëria¹ si zotërues i një Kuote mbi ndonjë trust dhe Shoqëria nuk mund të detyrohet në asnjë mënyrë, përveç rastit kur parashikohet në ligj, të njohë (edhe nëse ka njoftim mbi të) ndonjë interes të drejtë, të mundshëm, të ardhshëm apo të pjesshëm mbi ndonjë Kuotë (përveç rastit kur parashikohet ndryshe nga këto dispozita apo kërkesat e ligjit), apo çfarëdolloj të drejte tjetër të lidhur me Kuotat, përveç të drejtës absolute mbi tërësinë e saj, që gëzon çdo Ortak i regjistruar në Regjistër, përveç rastit kur, pavarësisht parashikimeve të mësipërme, Drejtorët vendosin një gjë të tillë në diskrecionin e tyre të plotë dhe Shoqëria në këtë rast ka të drejtë të njohë interesa të tilla.

PRISHJA E SHOQËRISË

139. Në rast se Shoqëria priset, likuiduesime anë të një vendimi të zakonshëm, ka të drejtë të ndajë ndërmjet Ortakëve të gjitha apo një pjesë të kontributeve në para apo në natyrë (edhe nëse ato konsistojnë ose jo në pronë të të njëjtit lloj). Likuiduesi ka të drejtë që për këtë qëllim të vendosë për çdolloj prone që do ndahet si mësipër, një vlerë që ai e mendon të drejtë dhe gjithashtu do të përcaktojë mënyrën se si kjo vlerë do të shpërndahet ndërmjet Ortakëve të Klasave të ndryshme. Likuiduesi ka të drejtë, që në rastet që ai e mendon të dobishme, në përputhje me parashikimin e mësipërm, t'ë kalojë një pjesë, apo të gjitha pronat në administrim me mirëbesim, për përfitimin e Ortakeve, por

në asnjë rast një Ortak nuk mund të detyrohet të pranojë një pasuri mbi të cilën ekziston një detyrim.

NDRYSHIMET E NENEVE TË STATUTIT

140. Në bazë të dispozitave ligjore dhe të drejtave që lidhen me përkatësinë në një Klasë të caktuar, Shoqëria ka të drejtë që në çdo moment dhe herë pas here, me Vendim të Veçantë, të ndryshojë Nenent e këtij Statuti tërësisht, ose pjesërisht.

MBYLLJA E REGJISTRIT DHE PËRCAKTIMI I DATËS SË REGJISTRIMIT

141. Me qëllimin që të përcaktohen Ortakët që gëzojnë të drejtën për t'u njoftuar, të marrin pjesë apo të votojnë në Mbledhjet e Ortakëve, apo në Mbledhjet e shtyra, apo Ortakët që gëzojnë të drejtën të paguhet për dividendet, apo për të përcaktuar se cili është Ortaku për çfarëdo qëllimi, Drejtorët mund të vendosin që Regjistri të jetë i mbyllur për çdo transferim, për një periudhë të caktuar, në asnjë rast më të gjatë se 40 ditë. Nëse Regjistri do të mbyllet me qëllim që të përcaktohet se cili Ortak ka të drejtë të njoftohet për të marrë pjesë, apo cili ka të drejtë të votojë në një mbledhje të Asamblesë së Ortakëve, Regjistri do të mbyllet të paktën 10 ditë përpara mbledhjes në fjalë dhe data në të cilën është marrë ky vendim do të jetë dhe data e mbylljes së Regjistrimit.
142. Në vend të, apo përveç mbylljes së Regjistrimit, Drejtorët mund të caktojnë një datë të mëparshme se data e regjistrimit për të përcaktuar Ortakët që kanë të drejtë të njoftohen për marrjen pjesë, apo dhe votimin në një Mbledhje të Ortakëve. Me qëllim përcaktimin e Ortakëve që kanë të drejtë të përfitojnë dividende, Drejtorët kanë të drejtë që brenda 90 ditëve përpara datës së deklarimit të dividendëve, të caktojnë një datë të mëvonëshme se data e regjistrimit për të marrë një vendim të tillë.
143. Nëse Regjistri nuk mbyllet si mësipër dhe nuk caktohet asnjë datë për përcaktimin e Ortakëve që kanë të drejtë të njoftohen për zhvillimin, të marrin pjesë, si dhe të votojnë në Asamblenë e Ortakëve, apo përcaktimin e atyre Ortakëve që kanë të drejtë të përfitojnë dividende, si datë në të cilën janë përcaktuar këta Ortakë do të konsiderohet sipas rastit, data në të cilën është bërë njoftimi për mbledhjen, ose data në të cilën Drejtorët kanë marrë vendim për shpalljen e këtij dividendi. Nëse përcaktimi i Ortakëve që kanë të drejtë të njoftohen, të marrin pjesë, apo të votojnë në mbledhjet e Asambleve të Ortakëve, është bërë sipas parashikimeve të këtij Neni, ky përcaktim do të jetë i vlefshëm për çdo shtyrje të mundshme të mbledhjes.

REGJISTRIMI PËR VAZHDIMËSINË E SHOQËRISË

144. Shoqëria, me anë të një Vendimi të Veçantë, të vendosë që me qëllim vazhdimin e aktivitetit të saj, të regjistrohet në një juridiksion jashtë territorit të Cayman Islands, apo në një juridiksion tjetër në të cilin ajo është themeluar, regjistruar apo në të cilin ekziston në atë moment. Në vijim të një vendimi të marrë sipas kësaj dispozite, Drejtorët kanë të drejtë të depozitojnë në Regjistrin e Shoqërive një kërkesë për të çregjistruar Shoqërinë nga Cayman Islands, apo nga çdo juridiksion tjetër në të cilin ajo është regjistruar apo ekziston në atë moment. Drejtorët kanë të drejtë të ndërmarrin të gjithë veprimet e mëtejshme, që ata konsiderojnë të nevojshme për të ekzekutuar transferimin në fjalë, me qëllim vazhdimësinë e Shoqërisë.

PARAQITJA E TË DHENAVE


145. Drejtorët, apo Persona të tjerë të autorizuar (përfshirë këtu nëpunësit, Sekretarin apo agjentin e regjistruar të Shoqërisë), kanë të drejtë t'i paraqesë çdo autoriteti gjyqësor apo një autoriteti tjetër rregullues, çdo informacion që lidhet me veprimtaritë e Shoqërisë, përfshirë këtu pa asnjë kufizim informacionet që permbajnë Regjistrat dhe librat e Shoqërisë.

VËRTETOHET ORIGINALI DHE KORREKTËSIA E KOPIJES.

Nënshkruar : Joy A. Rankine
Asistent i Regjistrues

23 Korrik 2007 (Firma, Vula)

Përktheu nga anglishtja në shqip: Joana Qeleshi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1622 Rep.



VERTETIM

Vertetoj nenshkrimin e perkthyeses se gjuhes angleze Joana Qeleshi, e njohur prej meje noteres ne baze te ligjes, banuese ne Tirane, e cila me deklaroi se ka perkthyer dokumentin bashkangjitur " Statuti e Akti i Themelimit" i shoqerise tregtare "STREAM OIL & GAS" ltd, njelloj me origjinalin, nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe dhe firmos rregullisht para meje noteres. Une noteria vertetoj nenshkrimin e saj sipas ligjit "Per Noterine" nr.7829 date 01.06.1994.

Tirane me 26/09/2007

NOTERE

Laurea Gusting

Paktheu me Anglishtje

Joana Qeleshi

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

